

Date 22.04.2026

**Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i procedurës:** “Blerje dhe Rinovimi i paisjeve dhe komponentëve të infrastruktures IT dhe të sistemeve të kontrollit të aksesit”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Pajisje kompjuterike dhe furnizime 30200000-1

Pajisje kompjuterike 30237200-1

Kamera dixhitale 38651600-9

**Vlera e fondit limit:** 2.973.350 (dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind pesëdhjetë) lekë pa TVSH..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 përkatësisht në vlerën vlerën 59.467 (pesëdhjetë e nënte mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë. (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006)“Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar si kompani sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

b) **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme); ). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme); ). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

*Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të*

*plotë, bazuar ne organizimin e brendshem per menaxhimin sa me te mire te cilesise implementuese.*

*Certifikimi ISO 27001:2022 ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke siguruar qe informacionet te menaxhohen ne menyre te sigurte nga pikepamja informatike dhe te jene te kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to te jete i verifikueshem e i kodifikuar.*

*Certifikimi ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke qene se zoteron nje sistem menaxhimi per sherbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shume garanci qe ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin ne teresi i cili eshte teresisht i bazuar ne produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe ne kategorine e mbrojtjes kibernetike.*

**2.3.3** Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen dhe shërbimin për të gjithë zërat objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota me objekt dhe numer reference të procedurës dhe detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë të cilët kanë eksperience në fushën përkatëse dhe e kanë normale marrëdhënien të pakten me distributorët e autorizuar për produktet dhe shërbimet që kerkohen. Për Autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara

në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar për të paktën muajin e fundit (*nga data e publikimit të njoftimit të kontratës*) dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) Te paktën 1 (nje) Inxhinier në fushën e Elektronikës ose ekuivalente (për këto kriter të dorezohet diploma perkatese te paktën ne nivelin Bachelor);
- b) Te paktën 1 (nje) Teknik të certifikuar nga prodhuesi për Sistemin e Kontrollit të Aksesit (instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve) ose ekuivalente;
- c) Te paktën 1 (nje) Teknik të certifikuar nga prodhuesi për Sistemin CCTV (instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve) ose ekuivalente;
- d) Te paktën 1 (nje) specialist të certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente;

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjese e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat/diplomat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet të vërtetojë se i ka të punësuar për periudhën e dates së hapjes së tenderit.*

*Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:*

- *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm.*
- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vërtetues, për muajin e fundit;*

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të

**këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”**

**Argumentimi:** Ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë personelin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i personelit të kërkuar specifik, sipas specializimeve është minimal dhe në proporcionalitet me vlerën e prokuruar, volumin e produkteve-shërbimeve dhe garancite perkatëse që kërkohen.

**Argumentimi Teknik:** Për kriterin në pikën a) duke qenë se objekt i prokurimit janë produkte shërbime dhe procese TIK, të cilat sigurisht janë pajisje elektronike dhe informatike, duke qenë se është procedurë me furnizim-vendosje, me qëllim projektimin edhe implementimin e saktë dhe mirëmbajtjen e tyre në mënyrën e duhur, është mëse e nevojshme që OE/BOE ofertues të ketë në stafin e tij të pakten 1 (një) inxhinier të diplomuar në fushën e Elektronikës ose ekuivalente, duke garantuar AK për projektim e implementim (FV) të saktë dhe mosndërprerje të shërbimit dhe vijimesinë e punës për zgjidhjen e ofertuar.

**Argumentimi Teknik:** Për kriterin në pikën b) duke qenë se objekt i prokurimit përfshin produkte TIK e shërbime të sistemit të akses-kontroll, të cilat kanë specifikën e tyre të veçantë, duke qenë se është procedurë me furnizim-vendosje, me qëllim implementimin e saktë dhe mirëmbajtjen e tyre në mënyrën e duhur dhe në afatë të shkurtra kohore, është mëse e nevojshme që OE/BOE ofertues të ketë në stafin e tij të pakten 1 (një) Teknik të certifikuar nga prodhuesi për Sistemin e Kontrollit të Aksesit ose ekuivalente, duke garantuar AK për instalim e konfigurim të saktë specifik (FV) dhe për mbajtjen e shërbimit të garancise perkatëse të sistemit, për mosndërprerje të shërbimit dhe vijimesinë e punës për zgjidhjen e ofertuar. Certifikata e specializimit kërkohej nga prodhuesi perkatës pasi AK duhet të garantohet për garancinë dhe jetegjatesinë e sistemit që po prokurohet, dhe nga eksperiencia është vërtetuar që këto elemente garancie ofrohen shumë më mirë nga OE / BOE që kanë lidhje direkte apo indirekte me prodhuesit e zgjidhjes akses-kontroll dhe kur specialistet janë të certifikuar nga kanalet zyrtare të prodhuesit perkatës të zgjidhjes në fjalë.

**Argumentimi Teknik:** Për kriterin në pikën b) duke qenë se objekt i prokurimit përfshin produkte TIK e shërbime të sistemit të regjistrimit e monitorimit vizual CCTV, e cila ka në specifikën e vet, duke qenë se është procedurë me furnizim-vendosje, me qëllim implementimin e saktë dhe mirëmbajtjen e tyre në mënyrën e duhur dhe në afatë të shkurtra kohore, është mëse e nevojshme që OE/BOE ofertues të ketë në stafin e tij të pakten 1 (një) Teknik të certifikuar nga prodhuesi për Sistemin CCTV ose ekuivalente, duke garantuar AK për instalim e konfigurim të saktë specifik

(FV) dhe per garantimin e funksionalitetit dhe shërbimit te garancise perkatese te sistemit, per mosndërprerje të shërbimit dhe vijimesine e punes për zgjidhjen e ofertuar. Çertifikata e specializimit kerkohet nga prodhuesi perkatese pasi AK duhet te garantohet per garancine dhe jetegjatesine e sistemit qe po prokurohet, dhe nga eksperiencia eshte vertetuar qe keto elemente garancie ofrohen shume me mire nga OE / BOE qe kane lidhje direkte apo indirekte me prodhuesit e zgjidhjes CCTV dhe kur specialistet jane te certifikuar nga kanalet zyrtare te prodhuesit perkatese te zgjidhjes ne fjale.

**Argumentimi Teknik:** Per kriterin ne piken **d)** duke qene se objekt i prokurimit jane produkte shërbime dhe procese TIK, ruajtje te dhenash/imazhesh qe gjënerohen, menaxhohen, trasmetohen, sinkronizohen dhe këmbehen nga sistemi qe do implementohet ne sistemin ekzistues teknologjik te Autoritetit Kontraktor, eshte furnizim-vendosje, eshte e nevojshme qe OE apo BOE te kete ne stafin e tij, te **paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve TIK ose ekuivalente**” për te vene ne zbatim ekspertizen e tij profesionale per te gjitha llojet e te dhenave digjitale qe do regjistrohen, qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe te zbatohet legjislacioni vendas dhe ai i BE-se (per rregulloren GDPR etj te ngjashme) per ruajtjen sa me te plote te konfidencialitetit te te dhenave qe mund te jene te stafit te kompanise/AK-se apo te klienteve te shumte qe do menaxhoje ky sistem ne teresi. Ky çertifikim eshte vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin e zbatimit te rregulloreve per rendesine e madhe qe ka konfidencialiteti i te dhenave digjitale ne kuptim te legjislacionit aktual shqiptar dhe me gjere atij te BE-se;

**2.3.5** Per vleresimin e sakte te ofertes teknike, Operatori Ekonomik duhet te paraqese fizikisht, ne daten dhe oren e hapjes se ofertave muster te pajisjeve/komponenteve ne vijim:

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Pershkrimi</b>
1.4	Central Akses Kontrolli
1.5	Lexues RFID
1.6	Kamera IP AI
1.7	NVR AI

Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja e parametrave teknik te tyre me specifikimet e kerkuara eshte kusht skualifikues.

Mostrat do jene konfidenciale per secilin operator ekonomik.

Mostrat do te dorezohen ne zyren e prokurimeve te Autoritetit Kontraktor ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave.

*Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

**Argumentim:**

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë, konkretisht:

Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

Nënligjet përkatëse në zbatim të tij, përfshirë udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP); Parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, konkurrencës së ndershme dhe përdorimit sa më efikas të fondeve publike;

autoriteti kontraktor ka të drejtë dhe detyrim që të sigurohet që mallrat që do të furnizohen përmbushin në mënyrë reale dhe të verifikueshme kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mallrat që prokurohen përmes fondeve publike duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mostrat shërbejnë si mjet i drejtpërdrejtë për të verifikuar parametrat teknikë, funksionalitetin, cilësinë e materialeve, përputhshmërinë me standardet kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe për të identifikuar çdo mospërputhje eventuale që nuk mund të konstatohet vetëm mbi bazën e dokumentacionit të ofruar. Paraqitja paraprake e mostrave ndihmon autoritetin kontraktor të shmangë marrjen në dorëzim të mallrave të cilët, megjithëse janë kontraktuar, mund të rezultojnë të papërshtatshëm ose të ndryshëm nga ç’është ofruar në ofertë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre**

**Njësia E Prokurimit:**